



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA MALLAKASTËR  
KRYETARI

Nr. \_\_\_\_\_ Regj.

Ballsh, më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ . 2020

Lënda: **Dërgohet për publikim në Sistemin e Prokurimit Elektronik dhe Buletin e Njoftimeve Publike, Formulari i Njoftimit të Fituesit**

**AGJENCISË SË PROKURIMIT PUBLIK – TIRANË (SPE)**

për ngarkim në sistemin e prokurimit elektronik të APP, në adresën [www.app.gov.al](http://www.app.gov.al)

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT**  
**BASHKIA MALLAKASTËR**

Data 19.10.2020

**Për: Operatorin Ekonomik “HE & SK 11” shpk, me NIPT L19008502B, me adresë Lagjja “Mustafa Matohiti”, Rruga “Mustafa Matohiti”, banesa nr.31, shkalla nr.1, kati përdhe, Tepelenë.**

\* \* \*

Procedura e prokurimit: **“E hapur”**

Numri i references së procedurës: **REF-70472-09-02-2020**

Përshkrim i shkurtër i kontratës: **“Studim projektim i sistemit të furnizimit me ujë nga burimi i Poçemit për qytetin e Ballshit”**, me fond limit **20,483,876** (njëzetëmilion e katërqind e tetëdhjetë e tremijë e tetëqind e shtatëdhjetë e gjashtë) **lekë pa TVSH**, me afat **3 (tre) muaj**.

Publikime të mëparshme: Buletini i Njoftimeve Publike nr.66, datë 8 shtator 2020

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: **çmimi më i ulët X** oferta ekonomikisht më e favorshme

**Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:**

**1. Operatori Ekonomik “CIVIL CONS” shpk, me NIPT L813150150, ka paraqitur ofertën ekonomike në shumën prej 17,849,943 (shtatëmbëdhjetëmilion e tetëqind e dyzetë e nëntëmijë e nëntëqind e dyzetë e tre) lekë pa TVSH.**

**2. Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë (BOE) “ERSI/M” shpk, me NIPT J98624803O & “ARABEL – STUDIO” shpk, me NIPT L51812001S, ka paraqitur ofertën ekonomike në shumën prej 17,616,133.36 (shtatëmbëdhjetëmilion e gjashtëqind e gjashtëmbëdhjetëmijë e njëqind e tridhjetë e tre) lekë pa TVSH.**

**3. Operatori Ekonomik “HE & SK 11” shpk, me NIPT L19008502B, ka paraqitur ofertën ekonomike në shumën prej 17,849,734 (shtatëmbëdhjetëmilion e tetëqind e dyzetë e nëntëmijë e shtatëqind e tridhjetë e katër) lekë pa TVSH.**

#### **Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:**

**1. Operatori Ekonomik “CIVIL CONS” shpk, me dokumentacionin e paraqitur, nuk plotëson të gjitha kërkesat për kualifikim, sipas përcaktimeve të bëra në dokumentat e tenderit, pasi ka këto mangësi në dokumentacionin e paraqitur:**

- Nuk plotëson kërkesën e përcaktuar në pikën 2.3.3. të kapacitetit teknik, te Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, në Shtojcën 8 të dokumentave standarte të tenderit, pasi nuk ka paraqitur dokumentacion për të vërtetuar se ka pjesë të stafit dhe të figurojë në licencën e shoqërisë 1 (një) drejtues teknik Arkitekt Restaurator.

*Rrjedhimisht, referuar sa më sipër nga Operatori Ekonomik “CIVIL CONS” shpk nuk plotësohet kjo kërkesë.*

- Nuk plotëson kërkesën e përcaktuar në pikën 2.3.5. të kapacitetit teknik, te Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, në Shtojcën 8 të dokumentave standarte të tenderit, pasi nuk ka paraqitur dokumentacion për të vërtetuar se ka pjesë të stafit mbështetës 1 (një) inxhinier topograf, 1 (një) arkeolog dhe 1 (një) agronom.

*Rrjedhimisht, referuar sa më sipër nga Operatori Ekonomik “CIVIL CONS” shpk nuk plotësohet kjo kërkesë.*

**2. Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë (BOE) “ERSI/M” shpk & “ARABEL – STUDIO” shpk, me dokumentacionin e paraqitur, nuk plotëson të gjitha kërkesat për kualifikim, sipas përcaktimeve të bëra në dokumentat e tenderit, pasi ka këto mangësi në dokumentacionin e paraqitur:**

- Nuk plotëson kërkesën e përcaktuar në pikën 1 të Kriterëve të Përgjithshme të Pranimi/Kualifikimit, në Shtojcën 8 të dokumentave standarte të tenderit, pasi marrëveshja e bashkëpunimit ndërmjet dy anëtarëve të bashkimit “ERSI/M” shpk & “ARABEL – STUDIO” shpk, si dhe prokura e posaçme, nuk janë paraqitur në formën e kërkuar, pra nuk janë lidhur para një zyre noteriale sipas përcaktimit të bërë në këtë kërkesë.

Në pikën 1 të Kriterëve të Përgjithshme të Pranimi/Kualifikimit, në Shtojcën 8 të dokumentave standarte të tenderit, ndër të tjera është përcaktuar se: “Veç kësaj, nëse oferta dorëzohet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, duhet të dorëzohen: a.Marrëveshja e noterizuar sipas së cilës bashkimi i operatorëve ekonomikë është krijuar zyrtarisht; b.Prokura e posaçme.”.

*Rrjedhimisht, referuar sa më sipër nga BOE “ERSI/M” shpk & “ARABEL – STUDIO” shpk nuk plotësohet kjo kërkesë.*

- Nga njëri prej anëtarëve të BOE, konkretisht “ERSI/M” shpk, nuk plotësohet kërkesa e përcaktuar në pikën 2.2.3. e kapacitetit ekonomik dhe financiar, te Kriteret e Veçanta të

Kualifikimit, në Shtojcën 8 të dokumentave standarte të tenderit, pasi referuar dokumentit të ngarkuar në SPE, me emërtim “12. Vërtetim OSHEE” lëshuar nga FSHU (OSHEE GROUP) Tiranë, OSHEE-2020-5781330-PO (vërtetim me nënshkrim elektronik), datë 31.08.2020, rezulton se është paguar detyrimi për muajin Korrik 2020, ndërkohë që referuar datës së zhvillimit të kësaj procedure (05.10.2020), duhej të ishte paraqitur vërtetim për shlyerjen e detyrimeve të energjisë elektrike për muajin Gusht 2020, muaj i cili është maturuar në datën 30 Shtator 2020. Në nenin 26, pika 7, shkronja “c”, të VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ndër të tjera parashikohet se: “...Mosshlyerja e detyrimeve të energjisë elektrike përbën shkak për skualifikimin e operatorit ekonomik ..”. Gjithashtu, në nenin 9 (Pagesa dhe afati për kryerjen e saj), paragrafi 9.1, i kontratës së miratuar me Vendimin e ERE nr.109, datë 21.10.2011 “Për miratimin e kontratës së furnizimit me energji elektrike të klientëve jofamiljarë”, përcaktohet se: “Klienti do të paguajë detyrimin e përcaktuar në faturën mujore të konsumit të energjisë elektrike (titull ekzekutiv), si dhe kur është rasti, kamatëvonesat përkatëse dhe pagesën e rilidhjes së energjisë, jo më vonë se ditën e fundit kalendarike të muajit pasardhës të atij të faturuar.”.

Sa më sipër, referuar datës së zhvillimit të procedurës së prokurimit (05.10.2020) dhe përcaktimeve të bëra në vendimin e sipërcituar të ERE, rezulton se detyrimet e energjisë elektrike për muajin Gusht 2020 janë maturuar dhe anëtari i BOE “ERSI/M” shpk nuk ka paraqitur vërtetim për shlyerjen e detyrimit të këtij muaji, gjë e cila përbën shkak për skualifikim sipas nenit 26, pika 7, shkronja “c”, të VKM nr.914, datë 29.12.2014.

*Rrjedhimisht, referuar sa më sipër nga BOE “ERSI/M” shpk & “ARABEL – STUDIO” shpk nuk plotësohet kjo kërkesë.*

- Nuk plotëson kërkesën e përcaktuar në pikën 2.3.2. të kapacitetit teknik, te Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, në Shtojcën 8 të dokumentave standarte të tenderit, pasi nuk zotëron të gjitha kategoritë e liçencës të përcaktuara në këtë kërkesë. Konkretisht, nga të dy anëtarët e BOE nuk zotërohet kategoria 5.f.

*Rrjedhimisht, referuar sa më sipër nga BOE “ERSI/M” shpk & “ARABEL – STUDIO” shpk nuk plotësohet kjo kërkesë.*

- Nuk plotëson kërkesën e përcaktuar në pikën 2.3.3. të kapacitetit teknik, te Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, në Shtojcën 8 të dokumentave standarte të tenderit, pasi drejtuesit teknikë (inxhinierët gjeologë dhe inxhinierët hidroteknikë) tek të dy anëtarët e bashkimit, nuk figurojnë në listëpagesat e shoqërisë për periudhën Shkurt – Korrik 2020.

*Rrjedhimisht, referuar sa më sipër nga BOE “ERSI/M” shpk & “ARABEL – STUDIO” shpk nuk plotësohet kjo kërkesë.*

- Nuk plotëson kërkesën e përcaktuar në pikën 2.3.5. të kapacitetit teknik, te Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, në Shtojcën 8 të dokumentave standarte të tenderit, pasi asnjë nga anëtarët e bashkimit nuk ka paraqitur dokumentacion për të vërtetuar se ka pjesë të stafit mbështetës 1 (një) inxhinier hidroteknik, 1 (një) inxhinier mjedisi, 1 (një) arkeolog dhe 1 (një) agronom.

*Rrjedhimisht, referuar sa më sipër nga BOE “ERSI/M” shpk & “ARABEL – STUDIO” shpk nuk plotësohet kjo kërkesë.*

- Nuk plotëson kërkesën e përcaktuar në pikën 2.3.8. të kapacitetit teknik, te Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, në Shtojcën 8 të dokumentave standarte të tenderit, pasi oferta e

paraqitur është në një vlerë më të ulët se vlera minimale e lejuar, e përlogaritur nga Autoriteti Kontraktor në bazë të parashikimeve të VKM Nr.354 date 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikqyrje dhe kolaudim”.

*Rrjedhimisht, referuar sa më sipër nga BOE “ERSI/M” shpk & “ARABEL – STUDIO” shpk nuk plotësohet kjo kërkesë.*

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **Operatorin Ekonomik “HE & SK 11” shpk, me NIPT L19008502B, me adresë Lagjja “Mustafa Matohiti”, Rruga “Mustafa Matohiti”, banesa nr.31, shkalla nr.1, kati përdhe, Tepelenë**, se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej **17,849,734** (shtatëmbëdhjetë milion e tetëqind e dyzetë e nëntë mijë e shtatëqind e tridhjetë e katër) **lekë pa TVSH**, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Bashkisë Mallakastër lagjia “18 Prilli”, Ballsh, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të veprohet siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 09.10.2020

Ankesa: PO.

- Për këtë procedurë prokurimi ka paraqitur ankesë operatori ekonomik “STUDIO SERVICES “K-SA” shpk lidhur me dokumentat e tenderit.

Ankesa e operatorit ekonomik “STUDIO SERVICES “K-SA” shpk, është regjistruar në protokollin hyrës të AK Bashkia Mallakastër nr.2044 regj, datë 10.09.2020.

Për trajtimin e ankesës doli Urdhëri i titullarit të AK Bashkia Mallakastër nr.439, datë 10.09.2020 (shkresa nr.2044/1 regj, datë 10.09.2020) “Për pezullimin e procedurës ... dhe ngritjen e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesës (KSHA)...”.

Lidhur me trajtimin e ankesës, KSHA ka mbajtur aktin me nr.2044/2 regj, datë 11.09.2020, nëpërmjet të cilit është vendosur mos pranimi i ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik “STUDIO SERVICES “K-SA” shpk.

Me shkresën përcjellëse nr.2044/3 regj, datë 11.09.2020 “Dërgim akti “Shqyrtim ankesë”...”, palës ankimuese i është komunikuar akti nr.2044/2 regj, datë 11.09.2020 i Komisionit të Shqyrtimit të Ankesës mbi mos pranimin e ankesës. Gjithashtu, ky akt i është komunikuar palës ankimuese edhe nëpërmjet postës elektronike (email) në adresën e përcaktuar në ankesë.

OE “STUDIO SERVICES “K-SA” shpk nuk e ka ushtruar të drejtën e ankimit pranë KPP, brenda afatit të ankimit të parashikuar në LPP.

**TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR**

**Qerim Ismailaj**